



Sa Pejgamber i mrekullueshëm!

Sa moral madhështor!

I DËRGUARI I ALLAHUT

KRENARIA E GJITHËSISË

Osman Nuri TOPBASHI





TITULLI ORIGINAL
FAHR-I KÂÏNAT EFENDÎMÎZ

PËRKTHEU

Naile Sulaj

REDAKTOI

Ilir Hoxha

FAQOSJA

Bledar Xama

BOTIMI I

Prill 2021, Shkodër

PROGRESI BOTIME

Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti

Shkodër, Shqipëri

Mob: +355 67 340 6182

I DËRGGUARI I ALLAHUT

KRENARIA E GJITHËSISË

Sa Pejgamber i mrekullueshëm!

Sa moral madhështor!

Osman Nuri TOPBASHI



PARATHËNIE

Falënderimet e pafundme qofshin për Allahun Teala!

Sepse Ai na dha më sublimen e mirësive, dhuratën më të bukur, robin e Tij më të dashur dhe të Dërguarin e Tij si Pejgamber për ne...

Paqja dhe bekimet e pafundme qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, Krenarinë e Gjithësisë (a.s.)!

Sepse Pejgamberi ynë i Nderuar (a.s.), e jetoi jetën e tij për ne, u bë shembull i bukur për umetin e tij, shfaqti personalitetin më kulminant, jetoi moralin më të jashtëzakonshëm dhe të mrekullueshëm, si dhe e transmetoi edhe te të tjerët këtë moral.

I dha lamtumirën botës njerëzore pas plotësimit të fesë dhe Kuranit Famëlartë. Kurse neve na la pas trashëgiminë e karakterit dhe personalitetit më të mrekullueshëm.



Kur ai ishte në jetë, gjendja dhe veprat e umetit i paraqiteshin atij.

Edhe pasi ndërroi jetë, me urdhrin e Allahut Teala veprat tona i paraqiten përsëri atij.

Nëse veprat tona janë prej veprave të mira, Pejgamberi ynë i Nderuar (a.s.), gëzohet dhe falënderon Allahun...

Por, nëse veprat tona janë prej veprave të këqija, ai pikëllohet dhe kërkon falje tek Allahu për ne...

Ai është pejgamberi i mëshirës dhe dhembshurisë; edhe në mahsher do të bjerë në sexhde për umetin dhe me ndërmjetësimin e tij do t'i përgjërohet përsëri Allahut për shpëtimin e umetit.

Pejgamberi ynë i Nderuar, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, është një monument dhembshurie dhe mëshire për ne me jetën dhe vdekjen e tij, me këtë botë dhe me ahiretin e tij.

Sepse ai (a.s.), është mëshirë për botët...

Çfarë duhet të bëjmë ne për ta merituar këtë nimet dhe mirësi të mrekullueshme; për të shfaqur besnikëri ndaj tij?

Çfarë jete duhet të bëjmë që të mos e pikëllojmë atë fytyrë të bekuar e të nderuar, por përkundrazi ta bëjmë atë të buzëqeshë?

Sepse ai (a.s.), ka thënë:

“Kujdes, mos ma nxini fytyrën ditën e mahsherit (duke bërë mëkate!)” (Ibn Maxhe, Menasik, 76.)

Çfarë rruge duhet të ndjekim për këtë?

Ai (a.s.), na ka lënë dy amanete:



Librin (Kuranin) dhe Sunetin...

Na e ka bërë të ditur se, përderisa t'u dalim për zot këtyre dy amaneteve, nuk do të devijojmë nga rruga e drejtë që na ka treguar Ai dhe nuk do të ndahemi nga sirat-i mustekim.

Libri dhe Suneti janë Kurani Fisnik dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut (tradita profetike)... Ata janë esenca e Islamit dhe burimet themelore të tij. Ata e kanë burimin nga revelata hyjnore dhe janë të mbrojtur nga fuqia hyjnore.

Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i erdhi shpallja në moshën 40-vjeçare. Deri në atë moment Pejgamberi ynë i Nderuar (a.s.), kishte jetuar me një moral të pastër e madhështor.

Ndërmjet popullit të tij pati shfaqur një moral të pastër dhe personalitet të përkryer që do t'i bënin cilësitë el-Emin dhe Es-Siddik emrat e tij të dytë.

Shpallja hyjnore zbriti te ky njeri i përkryer. Kurani Famëlartë zbriti me nder te një zemër kaq e pastër, te shembulli më i jashtëzakonshëm i "kalb-i selim"-it (zembrës së pastër).

U bë Nurun ala nur (dritë mbi dritë)...

Për çdo besimtar deri në ditën e kiametit; të mbledhësh atë moral, atë personalitet, u bë lumturia më e rëndësishme...

Ai u bë përsipirtshmëri në ibadet, bukuri në sjellje, mirësi në moral, butësi në zemër, dritë në fytyrë, elokuencë në gjuhë, dhembshuri në ndjenja, thellësi në shikim dhe pishtar ndriçues për umetin në rrugën drejt xhenetit.



Ky libër i vogël është përgatitur për t'u dhënë sadopak fllad pranveror zemrave tona nga personaliteti i veçantë dhe morali madhështor i Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë (a.s.) dhe për të paraqitur disa faqe të vogla nga ajo figurë e jashtëzakonshme.

I lutem Zotit të Lartësuar që ta bëjë shkak për të përfituar të gjithë dhe një përpjekje të pranuar nga Ai në rrugën e kryerjes së falënderimit për mirësinë e të qenët umet i tij!

Osman Nuri TOPBASH

2017, STAMBOLL

ADHURIMI, MORALI
DHE PERSONALITETI
I KRENARISË SË GJITHËSISË,
TË DËRGUARIT TË ALLAHUT



*Ebu Kusafe (r.a.), shprehet:
Kur unë, nëna dhe tezja ime i dhamë besën
të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe u larguam
prej tij, nëna dhe tezja më thanë:*

*“Bir i dashur! Ne nuk kemi parë asnjë si ky
njeri! Nuk njohim njeri që ta ketë fytyrën më
të bukur, rrobat më të pastra dhe fjalët
më të buta se të tijat. Prej gojës së tij
të bekuar sikur dilte dritë.”*

(Hejsemi, VIII, 279-280)



ADHURIMI, MORALI DHE PERSONALITETI I KRENARISË SË GJITHËSISË

DY PRIRJE TE NJERIU

Allahu i Lartësuar e fton njeriun në xhenet.

Vetëm se në xhenet nuk e pranon atë me një gjendje të papjekur dhe injorante, por me një pjekuri të edukuar.

Jo me një nefsi që urdhëron vazhdimisht të keqen, por me një zemër që ka arritur prehjen shpirtërore me përmendjen e Zotit (dhikru'll-llahun)...

Jo me një zemër të mbushur plot e përplot me ndjenja të ndyra, por me një zemër të pastër...

Përfundimisht, me një besim të drejtë, vepra të mira dhe moral të lartë...

Të gjitha këto mbartin kuptimin e personalitetit të një njeriu të përsosur.



Njeriu e ka të domosdoshme që të ndërtojë një personalitet prej të cilit Allahu Teala është i kënaqur dhe të përvetësojë cilësitë e një njeriu të përsosur, në mënyrë që të pranohet në xhenet.

Domethënë;

Njeriu duhet të jetë fisnik dhe të arrijë një gjendje me të cilën ta meritojë xhenetin e mrekullueshëm.

Në natyrën e njeriut gjenden cilësitë si “marrja për shembull” dhe “imitimi”. Ai e formon personalitetin e tij me këto. Për shkak të kësaj nevojë të njeriut, Allahu (xh. xh.), nuk është mjaftuar vetëm me zbritjen e librit, por i ka dërguar njerëzimit edhe pejgamberë të cilët mund t’i marrë shembull dhe t’i pasojë. Ndërsa neve, umetit të kohës së fundit na ka falur dhe dhuruar Vulën e Profetëve, Krenarinë e Gjithësisë, të Nderuarin tonë (a.s.).

Allahu i Madhëruar e shpreh atë si mirësinë më të madhe dhe thotë: “Lekad menne’ll-llahu.”

Ndjekja e figurës së veçantë dhe moralit madhështor të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit goftë mbi të, është shkak absolut për arritjen e pëlqimit dhe dashurisë së Zotit (xh.xh.). Domethënë, përderisa një besimtar të mos përparojë në ibadetet dhe veprimet e tij sipas orientimit të Hazreti Pejgamberit, nuk mund ta arrijë pjekurinë për të qenë “Insan kamil” që do të thotë njeri ideal të cilin synon Islami. Ai gjithashtu nuk mund të arrijë as prehjen dhe lumturinë e vërtetë që i jep

“Allahu i Lartësuar e fton njeriun në xhenet jo me një nefsin që urdhëron vazhdimisht të keqen, por me një zemër që ka arritur prehjen shpirtërore me përmendjen e Zotit (dhikru’ll-llahun).”



feja, sepse Allahu Teala e ka shfaqur në personalitetin e Hazreti Pejgamberit (a.s.), modelin e “njeriut ideal” të cilin e synon Islami. Atë (a.s.), e ka dërguar si mëshirë për botët dhe e ka bërë personalitet shembullor për të gjithë besimtarët.

Hazreti Mevlana (k.s.), thotë për ta shprehur këtë kuptim sublim të pasimit të të Nderuarit tonë:

“Eja, o zemër! Festa e vërtetë është takimi me Muhamedin e Nderuar, sepse drita e gjithësisë është prej dritës së bukurisë së asaj qenieje të bekuar.”

Qëllimi i tasavvufit (mistikës islame), që do të thotë zbatim i Islamit si sahabët me mirësi/ devotshmëri/asketizëm, është që të ndërtojë personalitetin e njeriut të përsosur i cili pason Krenarinë e Gjithësisë, të Dërguarin e Allahut, alejhi’s-selam. Ata që përpiqen të bëhen si Hz. Pejgamberi, do të jenë pranë tij në atë ditë të vështirë që quhet Kiamet. Sepse ai thotë:

“Njeriu do të jetë bashkë me atë që e do.” (Buhari, Edeb, 96.)

Sa mund t’i ngjajmë atij?

Sa mund të bëhemi nxënës të atij?

Prehja e vërtetë shpirtërore dhe salltaneti real është ngjasimi ndaj tij. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), ka thënë:

“Unë jam pejgamberi që kam vuajtur më së shumti.”
(Shik. Tirmidhi, Kijamet, 34/2472.)

“Ndjekja e figurës së veçantë dhe moralit madhështor të të Dërguarit të Allahut (a.s.), është shkak absolut për arritjen e pëlqimit dhe dashurisë së Zotit (xh.xh.)”



Por, krahas të gjitha vuajtjeve që hoqi, ai (a.s.), ishte gjithmonë i mbushur plot me prehje shpirtërore. Humbi gjashtë prej shtatë fëmijëve dhe i varrosi me duart e veta, por prapë se prapë ishte i mbushur plot me prehje shpirtërore. Në Uhud humbi xhaxhain e tij flijues, Hamzanë dhe të dashurin e tij, Mus'ab ibn Umejrin, por prapë se prapë i mbështetej Zotit dhe i dorëzohej Atij.

Në sexhden e falënderimit që bëri mbi devenë e tij kundrejt një fitoreje të madhe si çlirimi i Mekës, ia atribuoi suksesin Allahut Teala me vetëdijen: “Jeta e vërtetë është ahireti.”

Ai (a.s.), ishte el-Emin (besnik) dhe es-Sadik (i sinqertë) edhe në gjuhën e armiqve më të tërbuar të tij...

Të jesh nxënës i tij do të thotë të jesh i mbushur plot me prehje shpirtërore, të jesh besnik, të jesh i drejtë dhe të jesh modest e durimtar në çdo lloj rrethane...

Të jesh nxënës i atij do të thotë të përfitosh nga përsipirtshmëria e tij...

Zoti na dhëntë suksesel..

Nëse mund ta japim me shembull këtë pikë pas pike, atëherë themi:

DËRSHPIRTSHMËRIA NË IBADET

Ibadet do të thotë që ta adhurojmë Zotin qoftë në forma të caktuara si namazi dhe agjërimi, qoftë në të gjitha fushat e jetës.

*“Hazreti Mevlana ka thënë: “Eja, o zemër!
Festa e vërtetë është takimi me Muhamedin e
Nderuar, sepse drita e gjithësisë është prej dritës së
bukurisë së asaj qenieje të bekuar.”*



Aparenca dhe forma duhet të jenë të përsosura në ibadet, por qëllimi i vërtetë është shpirtërorja dhe zemra. Andaj duhet ta pyesim veten:

Sa na shpijnë ibadetet tona në thellësitë e ndjenjave dhe ekstazës?

Zoti (xh.xh.), kërkon përkushtim në namaz dhe besimtarët që do të shpëtojnë, i përshkruan duke thënë:

“Ata që e falin namazin me përkushtim.” (Mu'minun, 2)

Ajo që duhet të kuptojmë, është kjo:

Allahu i Lartësuar nuk kërkon një namaz gjeometrik. Siç duhet të kthehet trupi drejt Qabesë, edhe zemra duhet të kthehet drejt Zotit. Zemra dhe trupi duhet të jenë në harmoni shpirtërore.

Namazi është burimi më i madh dhe më i rëndësishëm i ibadeteve që e shpijnë njeriun te deti i takimit me Zotin. Namazi është kulmi dhe esenca e të gjitha ibadeteve nga aspekti i përfshirjes, përmbajtjes dhe gradës.

Ja pra, me këtë gradë shpirtërore e ka falur Pejgamberi ynë i Nderuar namazin, për të cilin ka thënë: “Drita e syve të mi.” Hazreti Aishja (r.anha), tregon:

“Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), falte namaz, nga zemra e tij dëgjohej një zhurmë si vlimi i kazanit. Kur thirrej ezani, kishte një gjendje sikur nuk i njihje njerëzit që kishte përreth ngaqë do të dilte në audiencën e Allahut.” (Ebu Davud, Salat, 157; Nesai, Sehv, 18.)

“Njeriu do të jetë me atë që e do.”

(Buhari, Edeb, 96.)



I Dërguari i Allahut (a.s.), ka rendur në namaz në çdo lloj situatë dhe ka bërë sexhde me mallëngjimin për “tu bërë një rob falënderues”. Si shtesë ndaj farzeve ka falur edhe namazet sunete para dhe pas farzeve, duhanë, ishrakun, evvabinin, namazin e natës, namazin për përshëndetjen e abdestit, namazin e luftës, nevojës dhe të eklipseve.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik:

“Kërkoni ndihmë me durim dhe namaz...” (Bekare, 45)
Andaj besimtari në çdo lloj situatë duhet të nxitohet për të bërë sexhde duke shfaqur kështu nënshtrim të plotë ndaj urdhrit të Zotit (xh.xh.):

“Fefirru ila’ll-llah / Rendni drejt Allahut!” (Dharijat, 50)

Një namaz i falur me përkushtim dhe që fal prehje shpirtërore, e ndalon njeriun nga të këqijat.

Një namaz që falet në gjendje takimi me Allahun (xh. sh.), na mbron nga shqetësimet psikologjike, vesveset, depresioni dhe stresi, të cilat janë sëmundjet e periudhës sonë.

Sepse falë një namazi të kryer me përkushtim, njeriut i shtohet mbështetja dhe dorëzimi ndaj Allahut Teala. Si rezultat i këtij nënshtrimi, njeriu mbrohet nga sëmundjet psikologjike.

Njerëzit që preokupohen me shkencat humane dhe shoqërore, përpiqen për të gjetur shkaqet e problemeve

*“Ata që e falin
namazin me përkushtim.”*

(Mu’minun, 2)



dhe shqetësimeve në shoqëri. Ndërkohë faktori më i madh i problemeve psikologjike dhe sociologjike janë mangësitë në lidhjen ndërmjet njeriut dhe Zotit (xh.xh.).

Një shoqëri që fal namaz siç kërkon Zoti dhe në formën që ka treguar Pejgamberi (a.s.), është e shëndetshme fizikisht dhe shpirtërisht. Në epokën e lumturisë (periudhën e Hz. Pejgamberit), një mjek shkoi në Medine. Ai nuk gjeti punë për të bërë. Më në fund i Nderuari ynë (a.s.), e këshilloi që të kthehej pranë familjes. Po ashtu, kur u hedhim një sy transmetimeve që na kanë ardhur, nuk rastisim në ndonjë problem psikologjik në periudhën e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Sepse të pasurit dhe të varfrit, të sëmuret dhe të shëndoshët, të gjithë jetonin në një prehje të plotë shpirtërore që ua kishte dhënë Islami.

Edhe ibadetet e tjera duhet të kryhen në përputhje me qëllimet e tyre shpirtërore si namazi.

Agjërimi e bën njeriun që ta shtojë falënderimin ndaj Zotit kundrejt mirësive të Tij.

Sepse uria e përkohshme na bën ta konceptojmë vlerën e mirësive.

Ajo e forcon durimin dhe qëndrueshmërinë e zemrës.

Bëhet shkak që ta kuptojmë në mënyrë të mirëfilltë gjendjen e të varfërve dhe të të vetmuarve.

Zekati, sadakaja dhe infaku tregojnë përgjegjësinë e njeriut. Në Kuranin Fisnik zekati përmendet në 32

“Namazi është kulmi dhe esenca e të gjitha ibadeteve nga aspekti i përfshirjes, përmbajtjes dhe gradës.”



vende, sadakaja në 21 vende dhe infaku në 72 vende. Ne i përsërisim disa herë gjërat të cilave u japim rëndësi. Edhe Zoti (xh.sh.), na e shpreh qartë se sa shumë rëndësi i jep kësaj çështjeje duke na e përsëritur 125 herë qoftë në formën e zekatit, qoftë në formën e lëmoshës, apo qoftë në formën e infakut. Në ajetin fisnik thuhet për sa i përket çështjes së infakut:

“Të devotshmit të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi...” (Al Imran, 134)

Prej këtij ajeti duhet të kuptojmë se nga aspekti material të qenët i pasur nuk është kusht për infakun, por është kusht të qenët i pasur në zemër. Njerëzit e devotshëm bëjnë infak (japin për hir të Allahut) edhe kur janë në vështirësi. As’habu’s-Suffe, të cilët ishin nxënësit e Hz. Pejgamberit, edhe pse ishin të varfër, shkonin nëpër male, mblidhnin dru, i shisnin dhe ia vendosnin përpara të Dërguarit të Allahut ato që kishin fituar.

Ndërsa haxhi është një ibadet i cili bëhet shkak për ta kuptuar të fshehtë e shprehjes: “Vdisni para se të vdisni!”, duke na bërë ta përjetojmë që në këtë botë një Mahsher të ngjashëm me atë të botës së përtejme. Domethënë është një shembull i hyrjes në qefin i cili është rroba e fundit e jetës së përkohshme. Në haxh nuk ka “refes”, “fisk” dhe “xhidal”. Domethënë, ndalohen dëshirat epshore, mëkatet dhe debatet. Në këtë mënyrë është sugjeruar që kjo vetëdije të përhapet në të gjithë jetën.

“Namazi është burimi më i madh dhe më i rëndësishëm i ibadeteve që e shpijnë njeriun te deti i takimit me Zotin.”



Hazreti Mevlana na bën këtë kujtim, në mënyrë që të bëjmë një haxh me përsjirtshmëri:

“Ata që shkojnë në haxh, le të kërkojnë të zotin e shtëpisë atje (domethënë të Bejtull-llahut – Shtëpisë së Allahut). Pasi ta gjejnë Atë, Qabenë mund ta gjejnë në çdo vend.”

Domethënë;

Nëse një zemër arrin gradën e kalbi selim /zembrës së pastër, kalbi munib / zembrës së përkushtuar dhe nefsi mutmainne / nefsit të bindur plotësisht në fenë e Zotit, atëherë ajo gjithmonë është bashkë me Allahun Teala, sepse Zoti (xh.sh.), thotë: **“Ve huve meakum ejnema kuntum / Ai (Allahu) është me ju kudo që të gjendeni.”**

(Hadid, 4)

Kryerja me përkushtim e namazit, agjërimit dhe haxhit, i zhduk krizat sociale në shoqëri dhe i jep prehje shpirtërore kësaj të fundit. Kjo prehje shpirtërore është përjetuar në epokën e lumturisë, në periudhën e Omer ibn Abdulazizit dhe në tre shekujt e parë të perandorisë osmane. Zgjidhja kryesore e krizave në të cilat gjendet sot bota islame është kthimi te Zoti dhe adhurimi me përkushtim. Një adhurim i tillë që do ta reflektojë patjetër prehje shpirtërore dhe mirësi në marrëdhëniet njerëzore.

Allahu (xh.xh.), në ajetin fisnik thotë:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”

“Faktori më i madh i problemeve psikologjike dhe sociologjike përbëhet nga mangësitë e njeriut në marrëdhëniet me Zotin.”



Domethënë;

Nëse nuk funksionon “ijjaka na’budu / vetëm Ty të adhurojmë”, atëherë nuk funksionon as “ve ijjake nestain / vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”.

Nëse nuk realizohet një adhurim në kolektiv, ndërpritet ndihma hyjnore.

Gjithmonë gjendet kushti i kolektivit.

Për këtë arsye, marrëdhëniet njerëzore janë shumë të rëndësishme:

BUKURIA NË MUAMELAT

Siç quhet ibadet (adhurim) marrëdhënia që njeriu ka me Zotin, edhe “muamelat” quhen marrëdhëniet që njeriu ka me njerëzit e tjerë, me vëllezërit besimtarë, me njerëzimin mbarë, madje me të gjitha krijesat.

Feja jonë u jep një rëndësi të madhe marrëdhënieve të bukura. Për arritjen e kësaj bukurie në marrëdhënie me të tjerët është kusht posedimi i një besimi të përsosur.

Pejgamberi ynë i Nderuar ka thënë:

“Asnjë prej jush nuk mund të bëhet besimtar i përsosur derisa të dojë edhe për vëllain e tij atë që dëshiron për vete.” (Buhari, Iman, 7; Muslim, Iman, 71-72.)

Mangësitë dhe nënvlerësimet në muamelat, bëhen shkak edhe për mospranimin e ibadeteve. Për shembull,

“Agjërimi e bën njeriun që ta shtojë falënderimin ndaj Zotit kundrejt mirësive të Tij, sepse uria e përkohshme na bën ta konceptojmë vlerën e mirësive.”



agjërimi i atij që përgojon është i mangët. Siç nuk mund të ketë zekat me para të fituara duke zhvatur njerëzit, edhe atij që shkon në haxh me këto para të ndyra i thuhet: “La lebbeck / Nuk të përgjigjem!”

Në trajtimin e njerëzve me mirësi dhe drejtësi nuk gjendet as kushti i fesë. Në ajetin fisnik thuhet:

“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.” (Mumtehine, 8)

Shembulli më i përsosur i marrëdhënieve më të shkëlqyera është i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam. Pejgamberi ynë i Nderuar i ka trajtuar me një humanizëm të shkëlqyer jo vetëm besimtarët, por edhe të gjithë njerëzit e tjerë pa marrë parasysh fenë e tyre. Sepse besimtarët janë vëllezërit tanë, ndërsa të gjithë njerëzit e tjerë janë të njëjtët tanë në humanizëm. Për këtë arsye, i Nderuari (a.s.), ngrihej në këmbë kur kalonte një xhenaze çifuti. Ndërsa politeistëve u dërgonte ndihma ushqimore dhe monetare përgjatë zisë së bukës në Mekë para çlirimit të saj. Pothuajse i gjithë populli i Mekës u bë mysliman përgjatë çlirimit të Mekës për shkak të këtyre sjelljeve të mrekullueshme.

Pejgamberit (a.s.), ishte shumë i dhënë në dhembshuri dhe mëshirë ndaj besimtarëve. Ndërsa trajtimi që u bënte ai besimtarëve, ishte krejt tjetër. Ai shprehet:

*“Në Kuranin Fisnik
zekati përmendet në 32 vende,
sadakaja në 21 vende dhe infaku
në 72 vende.”*



“Unë jam afër çdo besimtari më shumë se nefsi i tij. Nëse dikush lë pasuri kur të ndërrojë jetë, ajo pasuri u përket të afërmve të tij. Por, nëse lë borxhe dhe jetimë, ai borxh më përket mua. Edhe përkujdesja ndaj jetimëve është detyrë e imja.” (Muslim, Xhum’a, 43.)

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), herë pas herë i pyeste sahabët:

“A ka ndonjë prej jush që ka vizituar sot ndonjë të sëmurë?”

“A ka ndonjë prej jush që ka ushqyer sot ndonjë të varfër?”

“A keni marrë pjesë sot në namazin e ndonjë xhenazeje?”
(Muslim, Fedail’s-Sahabe, 12.)

Këto pyetje edhe ne duhet t’ua bëjmë çdo ditë zemrave tona.

Sa shembull i mrekullueshëm i bukurisë në marrëdhëniet me të tjerët është edhe kjo histori e Hazreti Hasanit, i cili u rrit me përgjigje pozitive ndaj pyetjeve të mësipërme dhe që eci në gjurmët e ndritura të Hz. Pejgamberit:

Një ditë Hasani (r.a.), bëri tavaf Qabenë. Më pas shkoi te Makami Ibrahim dhe fali dy rekatë namaz. Pastaj e vendosi faqen te Makami dhe filloi të qante duke u lutur:

“O Zot! Robi Yt i vogël dhe i dobët ka ardhur te dera Jote. O Allah! Shërbëtori Yt i vobektë ka ardhur te dera

*“Të devotshmit të cilët japin lëmoshë
edhe kur janë në mirëqenie,
edhe kur janë në vështirësi...”*

(Al Imran, 134)



Jote. Lypësi Yt ka ardhur te dera Jote. Skamnori Yt ka ardhur te dera Jote!” Këtë e përsëriste disa herë.

Pastaj u largua prej aty. Në rrugë rastisi në disa njerëz të varfër që po përpiqeshin të ngopeshin me thërrime të thata buke. U dha selam. Ata e ftuan Hazreti Hasani që të hante bashkë me ta. Hasani (r.a.), u ul bashkë me të varfrit, (por ngaqë lëmosha ishte haram për ehli bejtin), u tha:

“Do të haja bashkë me ju nëse do ta dija se kjo bukë nuk është lëmoshë.” Pastaj u tha me mirësjellje:

“Çohuni të shkojmë te shtëpia ime!”

Të varfrit morën rrugën e shtëpisë bashkë me të. Hazreti Hasani (r.a.), u dha atyre ushqim, u dha rroba për të veshur dhe u futi edhe nga një sasi parash në xhep.” (Ebshihi, el-Mustatraf, Bejrut 1986, I, 31.)

Ne duhet të bëjmë jashtëzakonisht shumë kujdes ndaj mëkateve si mashtrimi, përgojimi dhe thashethemet të cilat i shkatërrojnë maumelatet, domethënë marrëdhëniet njerëzore dhe përhapin helm ndërmjet njerëzve.

Mashtrimi është dobësi e personalitetit. Është kanceri i zemrës.

Hazreti Aishja (r.anha), ka thënë:

“Për Resulullahun (a.s.), nuk kishte gjë më të keqe dhe të shëmtuar se mashtrimi. Nëse dëgjonte se dikush prej sahabëve kishte mashtruar sado pak në lidhje me ndonjë

“Për infakun nuk është kusht të jesh i pasur materialisht, por është kusht të jesh i pasur shpirtërisht.”



çështje, qëndronte larg atij sahabi dhe nuk dëshironte të takohej shumë me të derisa ta dëgjonte se ai ishte penduar.” (Ibn Sa‘d, I, 378.)

Nëse dëshirojmë që të mos na e kthejë kurrizin nesër në vendin e mahsherit Hz. Pejgamberi, për shefatin (ndërmjetësimin) e të cilit kemi nevojë, edhe ne duhet të marrin nga mirësjellja e tij në marrëdhënie me njerëzit dhe të përvetësojmë moralin e tij të lartë.

FINESA NË MORAL

Morali i Pejgamberit tonë të Nderuar, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, ishte i mrekullueshëm.

Ja një nga një mijë e një shembujt rreth finesës së tij:

Kur i Nderuari ynë, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, synonte t’ua bënte të qartë njerëzve se nuk u kishte hije gabimi që kishin bërë, u thoshte:

“Çfarë po më ndodh mua që ju shoh ju kështu?”
Domethënë i qortonte ata me një metodë plot finesë.
(Buhari, Menakib, 25, Ejman, 3.)

Enesi (r.a.), i cili i shërbeu atij për dhjetë vjet radhazi, flet rreth tij me shprehje plot sinqeritet dhe mallëngjim:

“Nuk kam ndjerë as aromë qelibari, as misku dhe as ndonjë lloj tjetër më të mirë se aroma e Resulullahut

“Hazreti Mevlana ka thënë:

“Ata që shkojnë në haxh, le të kërkojnë të zotin e shtëpisë (domethënë, të Bejtull-llahut). Pasi ta gjejnë Atë, Qabenë mund ta gjejnë në çdo vend.”



(a.s.). Nuk kam prekur ndonjë atlas apo ndonjë mëndafsh më të butë se trupi i bekuar i të Dërguarit të Allahut (a.s.).”

Nxënësi i tij, Thabiti, i cili po e dëgjonte, e pyeti duke iu drejtuar me llagapin e vet:

“O mjeshtër, ti sikur jeton gjithmonë duke parë Resulullahun (a.s.) dhe duke dëgjuar fjalët e tij të bekuara, apo jo?”

Enesi (r.a.), iu përgjigj:

“Po, pasha Allahun shpresoj ta takoj atë ditën e kiametit. Kur t’i shkoj pranë, do t’i them:

“O i Dërguari i Allahut! Të ka ardhur shërbëtori yt i vogël!”

Të Nderuarit tonë (a.s.), i kam shërbyer dhjetë vjet në Medine. Unë atë kohë isha një fëmijë i vogël. Jo çdo punë që e bëja, përputhej me atë që më thoshte Resulullahu (a.s.). Krahas kësaj, i Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, për asnjë punë që bëja nuk më tha “of”. Po ashtu nuk më tha: “Përse e bëre këtë? Përse nuk e bëre këtë?!”

(Ahmed, III, 222.)

Tashmë le ta pyesim veten tonë: A shohin fëmijët tanë një finesë të tillë islame te ne, punëtorët tanë, nxënësit tanë dhe ata që i kemi nën përgjegjësinë tonë?

*“Allahu është me ju kudo
që të gjendeni.”*

(Hadid, 4)



A do të mundemi të lëmë pas kujtime të tilla të bukura?

A është mirësjellja jonë ndaj të tjerëve në nivelin e mirësjelljes që presim prej tyre?

A do të mundemi të lëmë një zë të mirë pas vetes nën kubenë e këtij qielli?

Mirësjellja dhe finesa e Pejgamberit nuk ishte vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj krijesave të tjera, madje përfshinte edhe bimët. Ebu Du'shum el-Xhuheni transmeton nga babai i tij dhe ky i fundit nga babai i vet:

“Resulullahu (a.s.), pati parë një beduin që përpiqej të shkundte gjethë duke u rënë me shkop degëve të pemëve që t’ua jepte kafshëve për t’i ngrënë. Ai u tha tyre që kishte pranë:

“Ma sillni atë arabin. Por silluni butë me të dhe mos e frikësoni!” Kur e sollën beduinin, i tha:

“O arab! Hidhi gjethet duke i shkundur butë dhe me ëmbëlsi, jo duke u gjuajtur dhe duke i thyer (degët)!”

Akoma më duket sikur i shoh gjethet që patën rënë mbi kokën e bedunit.” (Ibnu’l-Esir, Usdu’l-Gabe, Bejrut 1417, VI, 378.)

BUTËSIA NË ZEMËR

Hazreti Enesi (r.a.), thotë: “Nëse i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e shihte tre ditë ndonjërin prej vëllezërve në fe, pyeste për të. Nëse ishte larg, lutej për të. Nëse ishte

“Kryerja me përkushtim e namazit, agjërimit, zekatit dhe haxhit, i zhduk krizat sociale në shoqëri dhe i jep prehje kësaj të fundit.”



në shtëpi, e vizitonte. Nëse ishte i sëmurë, shkonte dhe lutej për shërimin e tij.” (Hejsemi, II, 295.)

Sepse Pejgamberi ua mësonte këto rregulla sahabëve të tij duke i zbatuar së pari vetë:

Besimtarët duhet të jenë si dy duart që lajnë njëra-tjetrën. Besimtari duhet t’i konsiderojë gjithmonë më të lartë besimtarët e tjerë. Ai duhet t’i ndajë me ta të gjitha mirësitë që ia ka dhënë Allahu Teala.

Ata që nuk kanë butësi dhe që e kanë zemrën të ashpër e të ngurtë, e kanë të pamundur ta ndjejnë këtë sakrificë dhe vëllazëri. Besimtarët duhet t’i pastrojnë nga zemrat e tyre papastërtitë si urrejtja, smira dhe lakmia dhe duhet t’i zbukurojnë këto zemra me cilësitë e bukura si mëshira, dashuria dhe dhembshuria. Kështu, zemrat tona duhet t’i përfshijnë të gjitha krijesat duke u shndërruar në faltore. Domethënë, urrejtjen që e ndjejnë kundrejt mëkatit, nuk duhet ta shfryjnë te mëkatari. Ato duhet ta shohin mëkatarin si një zog i plagosur dhe ta mjekojnë. Thirrja e Hazreti Mevlanës në formën: “Eja, eja, çfarëdo që të jesh, përsëri eja!”, është ftesë për mjekimin me këtë udhëzim.

Xhabiri (r.a.), tregon si më poshtë sesi i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili kishte një zemër si faltore, u vinte në ndihmë të gjithëve:

“Resulullahu (a.s.), përgjatë udhëtimit ecte mbrapa, i ndihmonte të dobëtit që ishin në vështirësi, i hipte ata në deve pas vetes dhe lutej për ta.” (Ebu Davud, Xhihad, 94/2639)

“Unë për çdo besimtar jam më i afërt dhe më i lartë se vetja e tij. Nëse dikush lë pasuri kur të vdesë, ajo pasuri u përket të afërmeve të tij. Por, nëse lë borxh dhe jetimë, ai borxh më përket mua. Edhe përkujdesja ndaj jetimëve është detyra ime.” (Muslim, Xhum’a, 43.)



Bukuria e zemrës së tij të butë reflektonte edhe në fytyrë. Bukuria e ndritur shihej qartë në fytyrën e tij të bekuar.

BUKURIA E NDRITUR NË FYTYRË

Edhe fytyra e bekuar e të Nderuarit tonë (a.s.), ftonte te bukuria e Islamit.

Kur Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), po kthehej i mërzhitur nga Taifi bashkë me Hazreti Zejdin (r.a.), gjatë rrugës u ulën për të pushuar në një vresht. Pronarit të vreshtit i erdhi keq për ta dhe u dërgoi rrush me shërbëtorin e tij që quhej Addas. Pejgamberi (a.s.), filloi të hante me besmele. Kjo fjalë i bëri përshtypje Addasit. Andaj pyeti i mahnitur:

“Ju jeni një njeri ndryshe! Nuk u ngjani njerëzve të këtyre anëve! Kush jeni?”

Edhe i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, e pyeti:

“Nga je ti? Cilës fe i përket?”

Addasi i tha:

“Jam nga Ninova. Jam i krishterë!”

Resulullahu (a.s.), i tha:

“Domethënë ti je nga vendi i robit të devotshëm, Junus ibn Mettasë!”

“Lutja e Hazreti Hasanit: “O Zot! Robi Yt i vogël dhe i dobët ka ardhur te dera Jote. O Allah! Shërbëtori Yt i vobektë ka ardhur te dera Jote. Lypësi Yt ka ardhur te dera Jote. Skamnori Yt ka ardhur te dera Jote!”



Addasi u habit edhe më shumë. Andaj pyeti:

“Nga e njeh ti Junusin?”

Hz. Pejgamberi i tha:

“Junusi është vëllai im. Ai ishte një pejgamber. Edhe unë jam një pejgamber!”

Pas këtyre fjalëve në botën shpirtërore të Addasit filluan të shpërthenin burimet e besimit. Kështu që u ngrit me kënaqësi nga vendi, i kapi dorën Hazreti Pejgamberit (a.s.) dhe tha fjalën e dëshmisë (shehadetin). (Ibn Hisham, II, 30; Ja’kubi, II, 36.)

Edhe pas hixhretit në Medinë, dijetari çifut Abdullah ibn Selami (r.a.), i cili e pa Hz. Pejgamberin, i besoi atij duke thënë:

“Kjo fytyrë nuk gënjen kurrë!..”

Allahu i Lartësuar i përshkruan besimtarët që ishin me Pejgamberin duke thënë:

“...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes...” (Fet’h, 29) Sa shenja të sexhdes kemi ne në fytyrën tonë?

Po në fjalët tona?

RRJEDHSHMËRIA NË GJUHË

Pejgamberi ynë i Nderuar i kishte të ndritura edhe fjalët.

“Nëse i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e shihte tre ditë ndonjë prej vëllezërve në fe, pyeste për të. Nëse ishte larg, lutej për të. Nëse ishte në shtëpi, e vizitonte. Nëse ishte i sëmurë, shkante dhe lutej për shërimin e tij.” (Hejsemi, II, 295.)



Ebu Kursafe (r.a.), shprehet si më poshtë:

Shkova te Resulullahu (a.s.), bashkë me nënën dhe tezen për t'i dhënë besën dhe pasi u larguam prej tij, nëna dhe teza më thanë:

“Bir! Nuk kemi parë asnjëherë një njeri si ky! Nuk njohim ndonjë njeri tjetër që të ketë fytyrë më të bukur, rroba më të pastra dhe të jetë më fjalëbutë se ky. Prej gojës së tij duket sikur shpërthen dritë.” (Hejsemi, VIII, 279-280.)

Gjuha e një myslimani nuk duhet asnjëherë t'ia thyejë zemrën dikujt dhe ta lëndojë dikë. Ajo duhet të përhapë gjithmonë mëshirë.

Përfundimisht, një besimtar i përsosur duhet të flasë me gjuhën që NA MËSON KURANI:

1. Kavlen sediden = FJALË E DREJTË (Bekare, 59; Ahzab, 70.)

2. Kavlen kerimen = FJALË E VLEFSHME DHE E BUKUR (Isra, 23)

3. Kavlen ma'rufen = FJALË ME VEND DHE E PËR-SHTATSHME (Ahzab, 32)

4. Kavlen beligan = FJALË INFLUENCUESE (Nisa, 63)

5. Kavlen mejsuran = FJALË E PËRZEMËRT (Isra, 28)

6. Kavlen lejjinin = FJALË E BUTË (Taha, 44)

Le t'u bëjmë një llogari të gjitha këtyre fjalëve që dalin

“Resulullahu (a.s.), përgjatë udhëtimit ecte mbrapa, i ndihmonte të dobët të ish në vështirësi, i hipte ata në deve pas vetes dhe lutej për ta.” (Ebu Davud, Xhihad, 94/2639.)



nga gjuha jonë. Sa përputhen me këto rregulla? Sa prehje u jep gjuha jonë shpirtave?

Çfarëdo që qypi të ketë brenda, ajo rrjedh jashtë. Gjuha jonë përbëhet nga ato që shprehin ndjenjat:

FINEËA NË NDJENJA

Qendra e ndjenjave është zemra dhe zemra nuk punon drejtpërdrejt me vullnetin e njeriut. Sytë mund t'i mbyllim dhe dorën e gjuhën mund ta mbajmë, por frenimi i zemrës është diçka shumë më e vështirë. Për këtë arsye është e nevojshme dëlirja e zemrës. Të pastruarit e ndjenjave negative dhe arritja e finesës është arti më i vështirë i zemrës.

Pejgamberi ynë i Nderuar përgjatë gjithë jetës nuk është nxehur asnjëherë për veten e tij, nuk ka refuzuar asnjëherë kur i është kërkuar diçka dhe ka qenë një personalitet që me zemër dhe ndjenja të pastra e të dëlira dhe që qëndronte larg çdo lloj ndjenje negative. Zemra e tij rrihte gjithmonë me dhembshuri dhe mëshirë për umetin. Ai thoshte:

“Jeta ime është mirësi për ju. Flisni me mua dhe njoftoheni (për shpalljen dhe dispozitat hyjnore). Edhe vdekja ime është mirësi për ju. Veprat tuaja më shfaqen mua. Kur shoh një vepër të mirë, e falënderoj Allahun. Kur shoh diçka të keqe, i kërkoj falje Allahut për ju.”
(Hejsemi, IX, 24.)

“Qendra e ndjenjave është zemra dhe zemra nuk punon drejtpërdrejt me vullnetin e njeriut. Të frenuarit e zemrës është diçka shumë më e vështirë. Andaj është e nevojshme dëlirja e zemrës.”



Mirë, por a jemi të vetëdijshëm se të gjitha krijesat janë amanet për ne?

A punojmë për ta merituar faljen duke falur të tjerët?

A e posedojmë një horizont meditimi me të cilin mund ta perceptojmë këtë?

THELLËSIA NË SHIKIM

Pejgamberi ynë i Nderuar ishte gjithmonë në një gjendje meditimi të thellë. Në çdo gjë të këtij universi ai shikonte vulën e madhështisë hyjnore, vitrinat hyjnore dhe gdhendjet hyjnore. Ai (a.s.), shikonte qiellin dhe majat e këmbëve. Heshtja e tij ishte edhe më e madhe.

Sot ka shumë gjëra që i preokupojnë njerëzit me vështrimin e tyre. Faktikisht një zemër e shkujdesur shëtit gjithmonë nëpër vitrinat e shejtanit. Ajo zvarritet nga mashtrimi në mashtrim duke u shkujdesur ndërmjet mirazheve.

Ndërsa zemra e përsosur vështron vitrinat hyjnore, domethënë shfaqjet dhe gdhendjet e madhështisë hyjnore. Ajo, duke u mahnitur, e shton dëshirën dhe emocionin ndaj dhikrit, sepse meditimi është një çelës i besimit.

Përfundimisht;

Gjendja e zemrës është shumë e rëndësishme.

“Zemra e shkujdesur shëtit gjithmonë nëpër vitrinat e shejtanit. Ajo zvarritet nga mashtrimi në mashtrim duke u shkujdesur ndërmjet mirazheve. Ndërsa zemra e përsosur vështron vitrinat hyjnore, domethënë shfaqjet dhe gdhendjet e madhështisë hyjnore. Ajo, duke u mahnitur, e shton dëshirën dhe emocionin ndaj dhikrit.”



Është shumë e rëndësishme që zemra të dëliret, në mënyrë që të gjitha cilësitë që i kemi shtjelluar më sipër, të pranohen në audiencën hyjnore.

Nëse duhet ta shpjegojmë këtë me një shembull, atëherë themi:

Nëse në një gotë të kristaltë hidhet ujë i pastër apo sherbet i shijshëm dhe serviret në atë mënyrë, transparenca e gotës së kristalit e nxjerr në pah bukurinë e atij shërbimi. Ky do të ishte një shërbim dhe nderim i qëlluar.

Por, edhe sikur të hedhim ujë zemzemi në një gotë të papastër, (uji i zemzemit) e humb të gjithë bukurinë e tij. Kështu që ky nuk konsiderohet shërbim, por ofendim.

Në të njëjtën mënyrë, nëse zemrat janë të papastra, atëherë me to as nuk mund t'i paraqitet ibadet Allahut të Lartësuar, as nuk mund të shfaqen sjellje të moralit të lartë ndaj krijesave.

Sepse të gjitha këto e ndotin zemrën me papastërti shpirtërore si mendjemadhësia, smira dhe shtirja.

Siç dihet;

Nëse do të vendosim ilaç mbi një plagë pa ia pastruar qelbin, nuk do të ketë asnjë dobi, sepse shërimi arrihet me një ilaç që është vendosur vetëm pasi plaga të jetë pastruar.

Për ta shprehur këtë të vërtetë, Allahu Teala ka deklaruar-

“Nëse do të vendosim ilaç mbi një plagë pa ia pastruar qelbin, nuk do të ketë asnjë dobi, sepse shërimi arrihet me një ilaç që është vendosur vetëm pasi plaga të jetë pastruar. Kështu, për vendosjen e cilësive të bukura në zemër, së pari duhet të pastrohen cilësitë e këqija.”



ar se vetëm zemra e pastër është gjeja e vetme që vlen ditën e kiametit.

Edhe në fjalën e tevhidit (shehadetit) së pari gjendet sugjerimi “la ilahe”, domethënë, në fillim zemra duhet të pastrohet nga masivaja, domethënë nga çdo gjë që na largon prej Allahut (xh.xh.). Pastaj do të thuhet “il-lall-llahu”.

Nëse zemra nuk pastrohet, nuk do të ketë ndonjë ndikim të madh dhe do ta humbë përsëritshmërinë edhe nëse këto që thamë më lart realizohen formalisht. Nëse pastrohet, atëherë këto cilësi do të na afrojnë te Resulullahu, alejhi’s-salam.

Allahu i Madhëruar na dhëntë të gjithëve një zemër të pastër dhe një besim të dëlirë që përjetohet me dashuri! Gjithashtu na e mundësoftë që të bëjmë ibadete duke e pasur zemrën e trupin në harmoni dhe vepra që përhapin admirim.

Një zemër të tillë duhet ta posedojmë edhe për të kryer urdhrin: **“Lexo!”** (Alak, 1), i cili është dhënë në shpellën Hira, sepse vetëm një zemër e tillë mund ta forcojë mallëngjimin, dashurinë dhe besimin ndaj Allahut të Lartësuar duke e lexuar universin nga atomi e deri te trupi më i madh qiellor. Sa bukur shprehet një mik i Zotit:

“Allahu Teala është aq i dukshëm, saqë nuk shihet prej dukshmërisë së madhe të Tij.”

Ata që e dëlirin zemrën mund ta vërejnë këtë

*“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen,
për t’ju provuar se kush prej jush
do të veprojë më mirë.” (Mulk, 2)*



dukshmëri në çdo gjë. Ndërsa zemrat që kanë perde dhe janë të verbra, nuk mund të lexojnë dhe shikojnë asgjë nga të vërtetat hyjnore.

O Zoti ynë!..

Na ndihmo për ta mësuar moralin e lartë të Muhamedit (a.s.)!..

Jepu përsëritshmëri ibadeteve tona, finesë veprave tona dhe hijeshi moralit tonë!.. Jepu butësi zemrave tona, elokuencë gjuhëve tona, brishtësi ndjenjave tona dhe thellësi (seriozitet) shikimeve tona!..

Amin!..

“Abdullah ibn Selami, i cili ishte prej dijetarëve çifutë, kur e pa fytyrën e bekuar të të Dërguarit të Allahut (a.s.), u bë mysliman duke thënë:

“Kjo fytyrë nuk gënjen kurrë!” Sepse pamja e jashtme është paqyrë e botës së brendshme.”

PERSONALITETI
DHE KARAKTERI
I KRENARISË SË GJITHËSISË,
TË NDERUARIT TONË



*Njeriu e ka të pamundur
ta perceptojë me plot kuptimin e fjalës
vlerën e Pejgamberit tonë të Nderuar
(a.s.), sepse madhështia e tij është përtej
perceptimit njerëzor.*



PERSONALITETI DHE KARAKTERI I KRENARISË SË GJITHËSISË

VËRTETIMI I KARAKTERIT

Kjo botë është zgjedhur prej miliarda planetëve dhe është përgatitur si një vend sprove për njeriun. Çdo gjë është dhënë në këtë botë duke filluar që nga ajo më e vogla e deri te ajo më e madhja, në mënyrë që njeriu të afrohet te Allahu i Madhëruar. Domethënë se Zoti ynë e ka krijuar këtë botë pothuajse si një pasqyrë. Ka sjellë aty në ekzistencë çdo gjë për të c'lën ka nevojë njeriu dhe ka ekspozuar në atë paqyrë madhështinë hyjnore. Meditimi u bë një çelës i besimit.

Zoti (xh.xh.), na njoftoi si më poshtë edhe për qëllimin e sprovës duke u shprehur:

“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar



se kush prej jush do të veprojë më mirë.” (Mulk, 2)

Allahu Teala dëshiron që njerëzimi të posedojë një pjekuri shpirtërore e cila do të shfaqë sjelljet “ahsan” (më të bukura);

Një personalitet i cili do të bëjë ibadetin, vepra të mira dhe të formojë marrëdhënie të mirëfillta “ekmel” (më të pjekura, më të përsosura) shoqërore;

Një karakter i cili do të shfaqë sjellje “exhmel” (që i japin prehje dhe kënaqësi zemrës). Ai i fton në xhenetin e Tij ata që mund t’i përvetësojnë këto cilësi.

Për këtë arsye;

I dërgoi njerëzimit peygamberë të cilët do të ishin udhërrëfyes me vepra, fjalë dhe gjendje. Peygamberët i zgjodhi prej njerëzve që kishin një të shkuar të pastër. Nuk zgjodhi asnjë peygamber prej personaliteteve të paekuilibruara të cilët mund të qortoheshin me të shkuarën e tyre dhe të kundërshtoheshin me fjalët: “Edhe ti dikur i kë bërë këto mëkate duke ndjekur dëshirat vetjake!”

Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, është sulltani i peygamberëve... Karakteri dhe personaliteti i tij ishte në pikën më kulmore...

Ai (a.s.), pati qëndruar i pastër edhe në atë periudhën e injorancës. Vendasit e quanin atë “el-Emin / Besniku”. Ai ishte personaliteti më i përsosur dhe më i veçantë.

Kur Peygamberi ynë i Nderuar po u fliste për herë të parë të afërmve të tij për t’i ftuar në Islam, së pari vërtetoi

*“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë:
“Unë, me të vërtetë jam mysliman.”*

(Fussilet, 33)



personalitetin e tij. Andaj ua bëri atyre me shenjë drejt malit Ebu Kubejs dhe i pyeti:

“A do të më besonit nëse do t’ju thosha: Pas këtij mali gjendet armiku dhe po vjen drejt nesh. Ai do të na vrasë. Andaj merrni masa!”

Të afërmit dhe njerëzit e tjerë iu përgjigjën:

“Të besojmë. Edhe pse nuk e shohim anën pas malit, kurrë nuk do të dyshonim te lajmi që jep ti, sepse ti je Muhammedu’l-Emin (Muhamedi Besnik)! Ti je njeriu më i drejtë ndërmjet nesh. Çdo gjë që thua ti, është e vërtetë.”

Pasi Pejgamberi ynë i Nderuar e mori këtë aprovim prej tyre dhe ua vërtetoi të gjithëve personalitetin e tij, filloi detyrën e predikimit të fesë islame. Pas kësaj njerëzit e përgënjeshtroan vetëm për shkak të lakmisë, smirës, inatit dhe verbërisë së tyre.

Vetëm fytyra e bekuar e Krenarisë së Gjithësisë, e të Nderuarit tonë (a.s.), u falte njerëzve besim dhe siguri. Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, bëri hixhret në Medine, Abdullah ibn Selami (apo Husajni sipas emrit të vjetër), i cili ishte prej dijetarëve çifutë, u bë kureshtar për Resulullahun dhe shkoi pranë tij. Kur e pa fytyrën e tij të bekuar, u bë mysliman duke u shprehur:

“Kjo fytyrë nuk gënjen kurrë!” (Tirmidhi, Kijame, 42/2485; Ahmed, V, 451.)

*“...Allahu nuk do t’u japë kurrë
rast mohuesve që t’i shkatërrojnë besimtarët.”*

(Nisa, 141)



Sepse pamja e jashtme është pasqyra më e qartë e botës së brendshme.

Andaj një besimtar i përsosur duhet të posedojë një pjekuri shpirtërore nëpërmjet së cilës të mund të marrë nga të gjithë besimtarët pothuajse një diplomë e cila vërteton se ai ka një ndërgjegje të pastër.

Sa bukur i përshkruan ky ajet fisnik cilësitë që duhet të mbartë njeriu që fton për te Allahu (xh.xh.):

“Kush mund të flasë më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë (duke përhapur karakterin dhe personalitetin e Islamit): “Unë, me të vërtetë jam prej myslimanëve.” (Fussilet, 33)

Njeriu që i fton të tjerët për te Allahu, duhet t'i ketë veprat, sjelljet, ibadetet, marrëdhëniet, domethënë duhet t'i ketë të mira të gjitha gjërat. Pra duhet të jetë në përputhje me kënaqësinë e Allahut, të jetë i dobishëm për njerëzit dhe të qëndrojë larg degradimit.

Ai njeri duhet ta thotë me gjuhën dhe gjendjen e tij, duke u ndjerë krenar (nëse mund ta shprehim kështu):

“Unë jam prej myslimanëve!” Domethënë duhet të shprehet;

“Unë e përfaqësoj Islamin dhe myslimanët në nivelet më të larta. Rregullat e Islamit të cilat ju ftoj, së pari i praktikoj vetë. Zemrën dhe fjalët i kam të njëjta. Gjendjen dhe fjalët i kam të njëjta. Të gjitha këto bazohen te e vërteta.”

*“Gjallëria e trupave është një “Zil-li zeval”
hije që humbet. Ndërsa karakteri
dhe personaliteti nuk harrohen pas jetës provizore.
Froni i tyre vazhdon të ekzistojë
nëpër zemra deri në kiamet.”*



Përsëri ai duhet të posedojë një dinjitet dhe krenari që ta shprehë me zë të lartë se është mysliman dhe se i është dorëzuar Allahut (xh.xh.).

Në këtë mënyrë duhet gjithmonë të përhapë personalitetet dhe karakter.

Këtë duhet ta bëjë pa e humbur ekuilibrin përgjatë baticave dhe zaticave të jetës, pa u dorëzuar dhe pa u mërzhitur.

DIKËRISHT SI HUBEJBI...

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, u dërgoi mësues fiseve përreth për t'u mësuar Islamin. Edhe fiset Adal dhe Kare patën kërkuar mësues nga Resulullahu (a.s.). Për këto fise mori rrugën një delegacion prej dhjetë vetash. Por karvani ra në kurth. Tetë prej mësuesve ranë dëshmorë. Ndërsa dy të tjerët u kapën rob.

Në këtë ngjarje të dhimbshme e cila është shënuar në histori me emrin "Ndodhia Rexhi", robërit, domethënë Hubejbi dhe Zejdi (r.anhuma), u martirizuan me tortura shumë të rënda. Krahas këtyre, ata nuk bënë asnjë lëshim.

Përgjatë atyre momenteve Ebu Sufjani, i cili atë kohë ishte prej femohuesve dhe kryetari i kurejshëve, parashitroi një pyetje me të cilën sikur dëshironte të shihte gradën e besnikërisë së Hubejbit (r.a.), ndaj Pejgamberit tonë të nderuar:

"Hazreti Aliu ka thënë:

"Bëj një jetë të përsosur në atë mënyrë që njerëzit t'i marrë malli për ty sa të jesh në këtë botë dhe të mallëngjehen për ty pasi të ndërrosh jetë!"



“A do të dëshirojë që në vendin tënd të gjendej Muhamedi si kundërvlerë për shpëtimin e jetës tënde?”

Hazreti Hubejbi e pa me keqardhje Ebu Sufjanin, i cili, edhe pse dukej i pasur dhe i fortë, zemrën e kishte si një gërmadhë të mjeruar nga kufri dhe padrejtësia, dhe i tha këto fjalë të sinqerta:

“Jo vetëm që nuk do të doja që unë të gjendesha në familjen time dhe Pejgamberi të ishte këtu, por nuk do të pranoja kurrë që atij t’i ngulej qoftë edhe një gjemb në këmbë atje ku gjendet si kundërvlerë për të shpëtuar nga vdekja!”

Ebu Sufjani kundrejt kësaj panorame të pashoqe dashurie dhe personaliteti u detyrua të pohonte me xhelozë dhe admirim:

“Me të vërtetë çudi! Unë nuk kam parë në këtë botë njerëz që ta duan njëri-tjetrin aq sa e duan Muhamedin sahabët e tij.” (Vakidi, I, 360; Ibn Sa‘d, II, 56.)

Sahabët e nderuar nuk bënë lëshime në besim dhe tevhid. Besimi ndaj Allahut dhe afrimiteti ndaj Resulullahut ua kishin ndryshuar atyre këndvështrimin ndaj kësaj bote. Meditimi i tyre ishte thelluar, ndërgjegjja e tyre ishte zbutur, mëshira dhe dhembshuria e tyre kishte arritur pikën kulmore dhe perceptimi për t’i dhënë përparësi ahiretit ndaj kësaj bote në çdo gjë ishte shndërruar në vetëdijen e tyre.

Ata përpiqeshin për të shërbyer dhe për të bërë xhihad në rrugën e Allahut Teala me jetën, pasurinë, dijen,

“Islami i jep një karakter dhe personalitet të lartë besimtarit që e pranon atë. Myslimanët duhet ta marrin personalitetin dhe dinjitetin nga Islami.”



urtësinë dhe çdo gjë tjetër të tyre. Andaj që nuk hiqnin dorë nga asnjë lloj sakrifice në këtë rrugë, sepse këtë kishin mësuar nga Pejgamberi ynë i Nderuar.

Në të vërtetë Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk shfaqti asnjëherë mërzitje, lodhje, bezdisje dhe dobësi përgjatë periudhës trembëdhjetë vjeçare të Mekës e cila kaloi me mundime, tallje, vuajtje, tortura, kërcënime, bojkote dhe atentate. Ndërsa përgjigja ndaj kërcënimeve të kundërshtarëve dhe lëshimeve që ata prisnin prej tij, ishte me këtë qëndrueshmëri dhe rezistencë:

“Pasha Allahun, edhe nëse më vendosin diellin në dorën e djathtë dhe hënën në dorën e majtë për të më bërë të heq dorë nga predikimi i fesë së Allahut, unë përsëri nuk do të heq dorë nga kjo kauzë! Ose Allahu i Lartësuar do ta përhapë atë në të gjithë botën, (kështu që) merr fund edhe detyra ime, ose do të vdes në këtë rrugë!” (Ibnu'l-Esir, el-Kamil fi't-Tarih, II, 64.)

Dinjiteti dhe personaliteti që shfaqti ai, reflektoi edhe te sahabët e tij.

SHPIRTI I SAKRIFICËS

Shumë të rinj si Mus'abi (r.a.), i refuzuan duartrokitjet e rrugëve të Mekës, rrobat e stolisura dhe pasuritë e familjeve të tyre. Kjo botë u zvogëluar në sytë e tyre. Ndërsa bota e përtejme u bë horizonti i vetëm i tyre. Në çdo frymëmarrje mahnitëshin nga i Dërguari i Allahut

“Kurani Fisnik për myslimanin është letra që Zoti u ka dërguar robërve të Tij dhe udhërrëfyesi më i bukur.”



(a.s.). Qoftë edhe sakrificën më të vogël në rrugën e tij e konsideruan si mirësi për shpirtin e tyre. Radijall-llahu anhum / Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!

Sahabët si Habbabi dhe Bilali duruan kundrejt torturave më të rënda. Sahabët si Jasiri dhe Sumeja dhanë jetën, por nuk e braktisën tevhidin. Radijall-llahu anhum / Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!

Të lexuarit e letrave, me një gëzim dhe prehje shpirtërore të madhe para shpatave të mprehta të xhelatëve, të cilat Hz. Pejgamberi ua dërgonte mbretërve për t'i ftuar në Islam, u jepte një kënaqësi të papërshekrueshme atyre. Ata morën parasysh vdekjen. Kështu Harith ibn Umejr el-Ezdi (r.a.), i cili ishte njëri prej të dërguarve, u martirizua nga udhëheqësi i Gassanit.

Nëna jonë, Hazreti Hatixheja dhe i nderuari ynë, Hazreti Ebu Bekri, e harxhuan të gjithë pasurinë për vëllezërit e tyre. Ata i shërbenin vazhdimisht Resulullahut (a.s.), për çdo gjë.

Xhafer et-Tajjari jetoi në kurbet për 14 vjet radhazi, në Abisini ku pati shkuar me urdhrin e të Dërguarit të Allahut. Ai dhe shokët e tij u shndërruan në një maja dhe injeksion besimi me personalitetin dhe karakterin e tyre.

Rendën drejt Kuranit dhe jetuan me kulturën e Kuranit. Pasuan Sunetin dhe nuk përvetësuan asnjë gjë tjetër.

Ata me sinqeritetin dhe dëlirësinë e tyre, arritën pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut Teala. Kështu fituan nderimet materiale dhe shpirtërore. Dëshmuan kerametet dhe mrekuillitë. Ja një shembull prej tyre:

"Imam Karafi ka thënë:

"Sikur i Dërguari i Allahut të mos kishte asnjë mrekuill, do të mjaftonte si dëshmitar se ai ishte një pejgamber (i madh, qoftë vetëm civilizimi i virtyteve që formoi me) brezin e sahabëve që edukoi."



BLETËT MBROJTËSE

Kur kryetari i nxënësve të Kuranit, Asim ibn Thabiti (r.a.), u plagos prej shigjetave të qafirëve dhe e kuptoi se do të binte dëshmor përgjatë ndodhisë Rexhi, iu përgjëruea kështu Allahut të Madhëruar:

“O Allah! Unë e mbrojta fenë Tënde në fillim të ditës. Edhe Ti ma mbro trupin tim në fund të ditës!”

Urtësia e të luturit në këtë mënyrë ishte kjo: Kurejshët që dëshironin të merrnin hakun e luftës së Bedrit, për shkak të brutalitetit të tyre, kërkonin një pjesë nga trupi i Asimit që vërtetonte se ishte vrrarë. Për këtë dërguan njerëzit e tyre.

Por Allahu Teala dërgoi një mizëri bletësh për ta mbrojtur Asimin (r.a.). Kjo mizëri bletësh e mbuloi trupin e Asimit. Njerëzit e kurejshëve nuk ia dolën dot mbanë për të këputur një copë nga trupi i tij. (Buhari, Xhihad, 170; Megazi, 10, 28; Vakidi, I, 354-363.)

Armiqtë pritën deri në mbrëmje që bletët të largoheshin. Bletët u larguan, por këtë herë papritur filloi një shi i tmerrshëm. U formua rrëke dhe trupi i Asimit në ato momente u zhduk nga sytë. Zoti e mbrojti trupin e Asimit nga qëllimet e këqija të armiqve. Pas kësaj ngjarjeje Asimi u kujtua si “Dëshmori që e Mbrojtën Bletët”. (Ibn Hisham, III, 163.)

Mbrojtja e Allahut Teala vazhdon përderisa të shfaqet personaliteti dhe dinjiteti që kërkon Islami. Ndihma gjithmonë është në anën e besimtarëve. Në ajetin fisnik thuhet:

“Një myslimani kurrë nuk i ka hije që të presë nder dhe fisnikëri nga njerëzit qafirë dhe të humbur të cilët i kanë bërë padrejtësi njerëzimit dhe nuk i kanë dhënë kësaj bote asgjë tjetër përveçse gjak, dhimbje dhe lot në emër të civilizimit të vërtetë e human nëpërmjet zhvillimit në përpunimin e hekurit dhe epërsisë në teknologji.”



“..Allahu nuk do t’u japë kurrë rast mohuesve që t’i shkatërrojnë besimtarët.” (Nisa, 141)

Disa prej ngjarjeve në të cilat u shfaq në formën më të qartë fuqia e besimit dhe ndihma e Allahut, janë luftërat e Çanakalesë. Atë ditë ushtrisë turke nuk i kishte mbetur asnjë fuqi fizike. Por metafizika i mposhti fuqitë fizike. Armiqtë mendjemëdhenj që mbështeteshin te fuqitë të tyre fizike, u mposhtën. Fytyrat plot besim fituan. Fituan nënat që i edukuan ata dhe që i dërguan në front duke i lyer me këna dhe duke thënë: “Kjo është shenja e dëshmorit tim.”

Edhe kjo luftë u fitua vetëm me sakrifica si fitoret në epokën e lumturisë.

Muhaxhirët në epokën e lumturisë i braktisën pasuritë dhe pronat e tyre dhe bënë hixhret. Në njërën anë kishin interesat e kësaj bote, në anën tjetër Allahun dhe Resullullahun. Ata hoqën dorë nga çdo gjë dhe u strehuan te Allahu (xh.xh.).

Ata mund të mbeteshin si çdo njeri tjetër ndërmjet miliarda njerëzve, por personaliteti prej besimtari dhe sakrifica që shfaqën, i gdhendi ata në zemrat e të tjerëve.

Për shembull;

DHU’L-BIXHADEJNI

Kur i vdiq babai, nuk i la aspak pasuri. Xhaxhai i tij që ishte i pasur, e mori, e rriti dhe e bëri të pasur.

*“Ata që miqësohen me mohuesit e jo me besimtarët!
Vallë, tek ata kërkojnë fuqi, kur, në të vërtetë, e gjithë
fuqia i përket vetëm Allahut!”*

(Nisa, 139)



Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, bëri hixhret në Medine, edhe pse Abdullahu deshi të bëhej mysliman dhe të shkonte te Hz. Pejgamberi, xhaxhai i tij politeist e ndaloi ta bënte këtë. Kur Pejgamberi ynë e çliroi Mekën dhe u kthye në Medine, Abdullahut i mbaroi durimi dhe i tha xhaxhait të vet:

“O xhaxha! Kam pritur vazhdimisht të bëhesh mysliman. Por shoh se akoma nuk e do Muhamedin (a.s.). Të paktën më lejo që të bëhem unë mysliman!”

Xhaxhai i tha duke e kërcënuar me pasurinë e tij:

“Nëse do ta ndjekësh Muhamedin, do të ta marr çdo gjë që ta kam dhënë deri te rroba që ke veshur!”

Abdullahu (r.a.), nuk hezitoi aspak dhe i tha:

“Unë pasha Allahun ndjek Muhamedin (a.s.)! Madje e kam lënë adhurimin e gurëve dhe idhujve! Nëse dëshiron, mund t’i marrësh gjërat që mi ke dhënë!”

Xhaxhai i tij ia mori të gjitha gjërat deri te rrobat. Abdullahu (r.a.), shkoi pa rroba te nëna e tij. E ëma e ndau në dy pjesë qilimin e trashë. Abdullahu me gjysmën e parë mbuloi trupin nga beli e poshtë. Ndërsa me gjysmën tjetër mbuloi trupin nga beli e sipër. Ishte i vendosur. Do të nisej menjëherë për në Medine dhe do të takohej me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Çdo pengesë që kishte para, në sytë e tij dukej një hiç. Andaj nuk qëndroi dot më shumë dhe atë natë mori rrugën fshehurazi duke shpëtuar kështu nga fisi i tij që e kishte vënë në pozitë të vështirë.

*“Allahu Teala na ka dhënë mirësi
dhe dhunti të pafundme. Ndërsa mirësia më e madhe
e hyjnore është që na ka bërë besimtarë dhe umet të të
Dërguarit më të veçantë.”*



Pas një udhëtimit të gjatë dhe të vështirë, iu afrua Medines me duar dhe këmbë të copëtua. Fuqia e kishte lënë për shkak të urisë dhe etjes dhe ishte në gjendje të mjeruar. Entuziazmi i tij ishte i jashtëzakonshëm. Por një moment mendoi se nuk mund të dilte në audiencën e të Dërguarit të Allahut me ato lloj rrobash. Krahas kësaj, sahabi i ri që arriti ekstazën nga emocioni i takimit me Krenarinë e Gjithësisë, shkoi drejt e te Mesxhidu'n-Nebevi. Deri në kohën para agimit fjeti në xhami. Pejgamberi (a.s.), fali namazin e mëngjesit. Kur i hodhi një sy xhematit dhe deshi të kthehej në shtëpi, pa Abdullahun. Pejgamberi i Mëshirës (a.s.), i cili ishte vendstrehimi i të vetmuarve, skamnorëve dhe të dhunuarve, e përqafoi me dhembshuri dhe dashuri atë sahab të bekuar. Kur mësoi se emri i tij ishte Abduluzza, i tha:

“Ti je Abdullah Dhu’l-Bixhadejni! (Abdullahu që ka veshur dy gjysma qilimi.) Më qëndro pranë! Eja shpesh te unë!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), më së shumti interesohej me sahabët e Suffas ndërmjet të gjithë sahabëve, sepse siç interesoje me gjendjen dhe moralin e tyre, po i edukonte edhe me kulturën e Kuranit dhe me një pjekuri që do ta përhapnin Islamin në të gjithë botën.

Abdullahu (r.a.), qëndronte në Suffe dhe mësonte Kuranin Fisnik. Pas një kohe mësoi përmendësh shumë sure nga Kurani Fisnik.

*“Një jetë e stolisur me besim
dhe vepra të mira, e ndërton edhe ahiretin
që është jeta jonë e vërtetë.”*



Resulullahu, alejhi's-selam, e komplimentoi atë duke u shprehur:

“Ai ka ardhur duke bërë hixhret te Allahu dhe i Dërguari i Allahut! Ai është prej “evvah-ëve”, domethënë prej atyre që i përgjërohen shumë Allahut dhe që digjen me dashurinë ndaj Allahut!” Sepse ai i bënte shumë dhikër Allahut duke kënduar Kuran dhe i bënte lutje të sinqerta me shprehje të mallëngjyeshme.

Përgjatë luftës së Tebukut ra dëshmor duke ndërruar jetë nga malaria siç lajmëroi i Nderuari ynë (a.s.) dhe arriti nderin të vendosej në varr pikërisht nga vetë i Dërguari i Allahut (a.s.).

Abdullah ibn Mes'udi, (r.a.), i cili na e tregon këtë kujtim në lidhje me të, thotë:

“Sytë mu mbushën me lot kundrejt kësaj panorame. Andaj e lakmova Dhu'l-Bixhadejnin dhe në ato momente thashë me plot dëshirë:

“Ah sikur të isha unë ai që po hyn në këtë varr! Ah sikur të isha unë ai që po varroset me këtë kompliment të Pejgamberit!” (Shik. Ibn Hisham, IV, 183.)

Dhu'l-Bixhadejni (r.a.), ishte një sahab i varfër, por sakrificë e tij vazhdon të jetojë në zemrat besimtare që prej 1.400 vitesh. Kjo sakrificë u jep mësim të madh masave të gjera që erdhën pas tij dhe i udhëzon ato.

Sepse;

Trupi i gjallë është një hije që humbet. Ndërsa karakteri

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (Ahzab, 21)



dhe personaliteti nuk harron edhe pas kësaj jete provizore. Froni i tyre nëpër zemra vazhdon deri në kiamet.

Hazreti Aliu (r.a.), ka thënë:

“Bëj një jetë aq të përsosur, sa njerëzit t’i marrë malli për ty sa të jesh në këtë botë. Ndërsa pasi të ndërrosh jetë, të përmallohen për ty!”

Ata ishin personalitete shembullore që jetuan në këtë mënyrë dhe që kiheshin zili nga të tjetër.

Secili prej tyre ishte;

Karakter dhe personalitet me jetën e tij...

Karakter dhe personalitet me pasurinë e tij...

Karakter dhe personalitet me edukimin e fëmijës në rrugë të Allahut (xh.xh.)...

Shembulli më i bukur për personalitetin në lidhje me edukimin e fëmijës është Hazreti Abdulkadir Gejlani (k.s.) dhe nëna e tij e nderuar.

NDERSHMËRIA QË UDHËZOI BANDITËT

Babai i Hazreti Abdulkadir Gejlanit pati ndërruar jetë kur ky i fundit ishte i vogël. Abdulkadiri pati mbetur vetëm me nënën. Kishte pasion të madh për dijen. Për këtë arsye, dëshironte të shkonte e të merrte mësim në Bagdad që ishte qyteti i dijes së asaj periudhe. E bëri nënën e tij të pranonte pasi iu përgjërta pa reshtur. Nëna e tij i futi te një xhep i qepur 40 florinj që kishin mbetur nga babai dhe i tha:

“Nëse besimtari arrin të meditojë rreth madhësisë së mirësisë që posedon, përpiqet më shumë për të përfitur prej saj dhe për ta pranuar atë si një dhunti.”



“Këta kanë mbetur nga babai yt. Harxhoji për dije. Aman bir, kurrë mos gënje!” Pastaj e përcolli.

Banditët i prenë rrugën karvanit në të cilin gjendej Hazreti Abdulkadir Gejlani. Pasi ua morën të gjithëve çdo gjë që kishin, e pyetën edhe atë:

“A ke ndonjë gjë ti?” Ai u përgjigj:

“Po, kam. Në xhepin e qepur të rrobës kam 40 florinj.” Në fillim nuk i besuan, por më vonë vunë re se ishte e vërtetë. Andaj i thanë të habitur:

“Përse na tregove? Po të mos na tregoje, as që do të të kontrollonim ngaqë je një fëmijë!”

Hazreti Abdulkadir Gejlani tha:

“Kur dola nga shtëpia, i dhashë fjalën nënës se kurrë nuk do të gënjeja. Si mund ta thyej premtimin për dyzet florinj?!”

Kryetari i banditëve u prek shumë nga këto fjalë dhe u shpreh:

“Ky fëmijë i vogël e mban fjalën që ia ka dhënë të ëmës, në mënyrë që të mos bie në gjynah. Ndërkohë ne vazhdimisht e thyejmë urdhrin e Zotit. Ejani të pendohemi! Deri më tani ju kam udhëhequr në banditizëm. Kurse këtej e tutje do të jem prijësi juaj në hyrjen tuaj në rrugën e drejtë.” Të gjithë u penduan dhe u udhëzuan.

Ja një shembull sesi një personalitet i veçantë bëhet shkak për udhëzimin e njerëzve.

Allahu Teala i mban të gjallë ato personalitete të mëdha

*“Njeriu e ka të pamundur të perceptojë vlerën e
Pejgamberit tonë të Nderuar (a.s.),
me plot kuptimin e saj, sepse madhështia e tij
është përtej perceptimit tonë.”*



në mendjet e njerëzve. Umeti i Muhamedit përfitoi nga Hazreti Abdulkadir Gejlani. Dhe akoma vazhdon të jetë shkak për udhëzimin e njerëzve.

Edhe Hazreti Bahaeddin Nakshibendi (k.s.), përgjatë viteve të para të hyrjes në mistikën islame, u shërbeu njerëzve të sëmurë dhe në nevojë. Gjithashtu u shërbeu edhe kafshëve të plagosura. Madje dha një shërbim të pashoq në pastrimin e rrugëve ku kalonin njerëzit për shtatë vjet të plota. Në këtë mënyrë u bë shembulli më i bukur për zinxhirin që erdhi pas tij.

Islami i jep një karakter dhe personalitet të lartë besimtarit që e pason, sepse Kurani Fisnik për besimtarin është letra dhe udhërrëfyesi më i mirë që Zoti u ka dërguar robërve të Tij. Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), është shembulli më i mirë, domethënë një Kuran i gjallë.

Ata që e mbjellin farën e besimit në tokën e zemrës së tyre dhe i bëjnë shërbim asaj, ata që ia dedikojnë zemrën e tyre Kuranit dhe Resulullahut, bëhen shkak për udhëzimin e njerëzve ngaqë janë si shirat e begatë, të pastër dhe të butë të mëshirës hyjnore që i bëjnë bimët të çelin në pranverë.

Ja një shembull i mrekullueshëm:

ABDULLAH IBN MEŠ'UDI (R.A.)

Ai ishte një sahab që kulloste devetë dhe delet. Kishte një trup të dobët e të vogël dhe një fytyrë të këndshme.

*“Allahu i Lartësuar
ia ka bërë të përsosur dhe madhështore çdo cilësi të
Resulullahut (a.s.), për sa i përket çështjes së udhë
rrëfimit dhe shëmbëlltyrës.”*



Por ia hapi aq shumë zemrën të Dashurit të Allahut, saqë nuk u nda aspak nga Resulullahu që nga momenti kur u bë mysliman. Ai përfitoi nga burimi i dijes dhe urtësisë duke pirë prej tij derisa ngopej. Resulullahut (a.s.), i shërbeu duke sakrifikuar. Kur i Nderuari ynë tha:

“Kush do të këndojë Kuran (para mushrikëve në Qabe)?”, ai vrapoi menjëherë dhe këndoi Kuran me zë të lartë në Mesxhidu’l-Haram para politeistëve. Kështu që u rrah për vdekje në rrugë të Allahut (xh.xh.). Por falë këtyre sakrificave dhe ekspozimit të fisnikërisë së Islamit në këtë mënyrë krejt pa frikë, arriti një pjekuri shpirtërore deri në atë gradë, saqë filloi të dëgjonte dhikrin e kafshatave që hante.

Ibn Mes’udi (r.a.), në sytë e mushrikëve ishte një hiç. Një moment në Bedr, Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

“Vallë, çfarë po bën Ebu Xhehli? Kush mund të shkojë për ta parë?” Abdullah ibn Mes’udi (r.a.), doli për ta kërkuar dhe e gjeti atë të shembur përtokë. Vazhdimësinë e ngjarjes e tregon vetë sahabi si më poshtë:

Unë e gjeta atë ndërkohë që po jetonte momentet e fundit dhe e njoha. Ia vura këmbën në fyt dhe i thashë:

“O armik i Allahut! Allahu të poshtëroi dhe të përbuzi, apo jo?” (Ai i poshtri mendjemadh nuk hoqi dot dorë nga inati i femohimit dhe krenarisë djallëzore edhe në frymën e fundit dhe tha:)

“Allahu as nuk më ka poshtëruar, as nuk më ka përbuzur. Kush është më i lartë se unë ndërmjet njerëzve

*“Vallë, a nuk ta hapëm ty
(Muhamed) kraharorin (për të pranuar besimin)?”*

(Inshirah, 1)



që i ka vrarë populli i vet? O bari delesh! Ke hipur në një vend të lartë dhe të vështirë për t'u arritur! Andaj lëre këtë dhe më thuaj se kujt i përket fitorja sot!” Unë i thashë:

“I përket Allahut dhe të Dërguarit të Tij!” Pasi e vrava atë me shpatën e tij, shkova te Resulullahu (a.s.) dhe i thashë:

“E vrava Ebu Xhehlin!” Ai e falënderoi dhe lavdëroi Allahun dhe tha:

“Ai ishte Faraoni i këtij umeti.” (Buhari, Megazi, 12; Ahmed, I, 444; Ibn Hisham, II, 277; Vakidi, I, 89-90.)

Ibn Mes’udi, të cilin Ebu Xhehli e përbuzi duke i thënë: “Ti je një bari.”, përparoi aq shumë në shkollën e Kuranit dhe Sunetit, sa që u bë kadiu (gjykatësi) i Kufes pas vdekjes së Pejgamberit (a.s.). Nga ekoli i jurisprudencës së Kufes që formoi ai, u edukuan njerëz si Imam Azami Ebu Hanife. Ky Imam Azami që nuk i gjendej shoku dhe i ngjashmi në historinë e jurisprudencës botërore. Edhe pse Soloni dhe Hamurabi tentohet të shfaqen si shembuj për të, në fakt ata mund të jenë vetëm çirakët e tij.

Karafi, i cili ishte një prej figurave të njohura të metodologjisë së jurisprudencës islame, shprehet:

“Sikur i Dërguari i Allahut të mos kishte asnjë mrekulli, (vetëm civilizimi i virtyteve që themeloi me) sahabët të cilët edukoi, do të mjaftonte si dëshmitar se ai ishte një pejgamber shumë i madh.”

“Pejgamberët posedojnë një zgjuarsia dhe largpamësi të madhe.”



DËRDPARIMI I VËRTETË

Ja pra, Islami i jep pasuesit të tij një pjekuri të tillë, një personalitet të tillë, një karakter të tillë, një fisnikëri dhe një dinjitet të tillë.

Falë mësimit dhe edukimit të Resulullahut (a.s.), prej njerëzve që nuk ishin asgjë nisur nga e kaluara e tyre, u shfaqën njerëz që ishin çdo gjë dhe që i dhanë drejtim botës. Prej të vdekurve dolën të gjallët dhe prej qymyrit doli diamant.

Edhe në ditët e sotme myslimanët duhet ta marrin personalitetin dhe dinjitetin nga Islami. Asnjëherë nuk i ka hije një myslimani që të presë nder dhe fisnikëri nga njerëzit e kufrit dhe degradimit që i kanë bërë padrejtësi njerëzimit me zhvillimin e hekurit dhe epërsinë e teknologjisë dhe nuk i kanë dhënë botës asgjë tjetër përveçse gjak, dhimbje dhe lot në emër të civilizimit të vërtetë dhe human.

Në ajetin fisnik thuhet:

“Ata që miqësohen me mohuesit e jo me besimtarët! Vallë, tek ata kërkojnë fuqi (krenari dhe nder), kur, në të vërtetë, e gjithë fuqia i përket vetëm Allahut!” (Nisa, 139)

Me të vërtetë sahabët e nderuar arritën krenarinë nëpërmjet Islamit.

Njerëzit që nuk kalonin dot më tutje luftërave ndërmjet fiseve, u bënë udhërrëfyes që përhapnin drejtësinë dhe të vërtetën duke çliruar vendet e tjera. Ndërkohë që

*“Sytë e mi fllenë, por zemra ime nuk fle.
(Vazhdon t'i bëjë dhikër Allahut.)”*

(Buhari, Tehexhxhud, 16.)



perandoria bizantine dhe Sasane ishin dy superfuqitë e asaj periudhe, ushtritë e Islamit e zhdukën njëren nga faqja e dheut. Edhe perandorinë romake të lindjes që ishte faqja e zezë e padrejtësisë, e eliminuan.

Brezi i një populli analfabet, injorant, madje gjysmë i egër, formoi shkencën e burrave dhe zinxhirit të hadith-it, e cila ishte dija më e saktë dhe sistemi kontrollues i arkivit të botës. Ndërsa nga ana tjetër formoi civilizimin e virtyteve.

Myslimanët arritën nivelet më të përsosura që reflektonin personalitetet e tyre në dije, urtësi, letërsi, art dhe arkitekturë, domethënë në çdo fushë që është shfaqje e civilizimit.

Por përparimi i madh dhe i vërtetë ishte në botën shpirtërore.

Sahabët mësuan afrimitetin ndaj Zotit në mënyrë shpirtërore falë reflektimeve të mëdha që arritën nga burimi i profecisë. Në shikimin e tyre u bënë të qarta e vërteta e mirësia me të gjithë bukurinë e tyre dhe e keqja e degradimi me të gjithë shëmtinë e tyre. Ata ua reflektuan të njëjtin shpirt edhe brezave që erdhën pas tyre.

Vetë Resulullahu, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ishte shembulli më i mirëfilltë në përhapjen e së vërtetës. Edhe në ditët afër vdekjes, dha një shembull të pashoq jurisprudence dhe deklarimi pasurie me fjalët.

“Sahabët e mi! Kujt do që mund t’ia kem marrë pasurinë pa qenë i vetëdijshëm për këtë, ja ku është pasuria ime,

“Jeta ime është në dobinë tuaj: Ju flisni me mua, edhe unë flas me ju! Edhe vdekja ime është e mirë për ju: Veprat tuaja më shfaqen mua. Kur të shoh veprat tuaja të mira, do ta falënderoj Allahun për to. Kur të shoh veprat tuaja të këqija, do t’i kërkoj falje Allahut për ju.” (Hejsemi, IX, 24.)



le të vijë dhe ta marrë!.. Kujtdo që mund ta kem goditur në kurriz me të padrejtë, ja ku është kurrizi im, le të vijë dhe të më godasë!..” (Shik. Ahmed, III, 400.)

Edhe sahabët e nderuar të cilët i mësuari nga i Nderuari ynë këto rregulla të drejtësisë, u shpërndanë në të gjithë botën, përhapen të vërtetën dhe përfaqësuan personalitetin e drejtë dhe të mëshirshëm të Islamit. Njerëzit që e kishin arritur këtë pjekuri shpirtërore, e përfaqësuan dhe e predikuan Islamin qoftë edhe vetëm me gjendjen e tyre.

ÇLIRIMET SHPIRTËRORE

Kur padishahu i tretë osman, Murad Hani I, çliroi Kosovën, aty vendosi njerëzit e pastër të Anadollit. Kjo ishte politika për vendosjen e Islamit aty. 95 % e shqiptarëve u bënë myslimanë për shkak të personalitetit të veçantë dhe karakterit të pastër që shfaqën me jetesën e tyre familjet myslimane që shkuan aty nga Anadulli.

Dhjetë vjet pas çlirimit të Stambollit, u çliroi Bosnja më 1463. Fatih Sulltan Mehmet Hani dërgoi edhe atje njerëz të pastër nga Anadulli. Kështu u bënë myslimanë të gjithë boshnjakët. Po ashtu çlirimet shpirtërore vazhduan me njerëzit shembullorë që Fatihu çoi në zonën e Shkodrës. Edhe në atë vend një pjesë e konsiderueshme e popullit u bë mysliman.

Në perandorinë osmane ishin gjithmonë myslimanët ata që e zbatonin Islamin me çdo gjendje të tyre, der-vishët dhe tregtarët të cilët shfaqnin fytyrën e bukur të

*“Ai (a.s.), nuk ishte jurist, por Hytëbja e tij
e Lamtumirës u bë “Deklaratë e të Drejtave të Njeriut”
më e përsosur dhe më e veçantë.”*



Islamit, ata që realizonin çlirimin shpirtëror pas çlirimit në aparencë i cili eliminonte padrejtësinë dhe zullumin.

Ata myslimanë me çdo gjë të tyren u bënë dëshmitarët e Zotit (xh.xh.). Ata që i shihnin me mahnitje, i bënë të thoshin: “Sa fe e bukur që është kjo!” Ky ishte çlirimi i vërtetë. Pra, çlirimi i zemrës. Kështu, duke filluar që nga shekulli i 18-të, perandorisë osmane nuk i mjaftonte fuqia për ta mbrojtur Ballkanin. Sundimi i saj në atë zonë mori fund plotësisht pas luftërave të Ballkanit. Udhëheqjet e krishtera dhe komuniste bënë shumë padrejtësi dhe shtypje atje. Por krahas kësaj, edhe në ditët e sotme me qindra mijëra myslimanë vazhdojnë ta mbajnë fenë Islame në të gjithë Ballkanin duke filluar me në krye Bosnje Hercegovinën, Kosovën, Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Vendet përtej oqeanit si Indonezia, në të cilën sot jetojnë me miliona myslimanë, nuk u çliruan me asnjë ndërhyrje ushtarake përveçse me çlirim shpirtëror. Atje shkuan tregtarë myslimanë që punonin me ndjeshmërinë e haramit dhe hallallit. Udhëheqësit dhe populli i atjeshëm thanë:

“Sa fe e bukur që qenka kjo!” – dhe u bënë myslimanë.

Përfundimisht;

Një mysliman i vërtetë duhet ta shfaqë fytyrën e bukur dhe përshpirtshmërinë e Islamit me personalitetin e tij.

Predikimi më i madh i një myslimani krahas gjuhës është kultura dhe edukata e tij. Ai arrin ta bëjë këtë predikim duke i bërë njerëzit të mahniten kundrejt per-

“Pasi Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), e shpalli profecinë, iu bënë shumë sulme dhe atentate, por nuk doli askush që ta tallte apo përçmonte me të kaluarën e tij.”



sonalitetit të tij dhe duke u shprehur: “Sa njeri i mirë që qenka ky!”

Zoti (xh.xh.), na e mundësoftë që personaliteti dhe karakteri ynë, morali dhe bota jonë shpirtërore të përfitojnë nga gjendja e veçantë e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe e sahabëve të tij të zgjedhur!

Zoti i Lartësuar na bashkoftë me bashkësinë e myslimanëve të cilët i lavdëron duke u shprehur: “Kush mund të jetë më fjalëmirë?”, që mbartin krenarinë dhe dinjitetin e Islamit, që u shpërthen mëshirë nga zemra, që ftojnë te Allahu dhe që bëjnë vepra të mira!

Amin!..

*“Mua më ka edukuar Zoti.
Sa bukur që më edukoi!”*

(Sujuti, Xhamiu's-Sagir, I, 12.)

Përmbajtja

ADHURIMI, MORALI DHE PERSONALITETI I KRENARISË SË GJITHËSISË

DY PRIRJE TE NJERIU	11
PËRSHPIRTSHMËRIA NË IBADET	14
BUKURIA NË MUAMELAT	20
FINESA NË MORAL	24
BUTËSIA NË ZEMËR.....	26
BUKURIA E NDRITUR NË FYTYRË.....	28
RRJEDHSHMËRIA NË GJUHË	29
FINESA NË NDJENJA.....	31
THELLËSIA NË SHIKIM.....	32

PERSONALITETI DHE KARAKTERI I KRENARISË SË GJITHËSISË

VËRTETIMI I KARAKTERIT.....	39
PIKËRISHT SI HUBEJBI... ..	43
SHPIRTI I SAKRIFICËS	45
BLETËT MBROJTËSE	47
DHU'L-BIXHADEJNI	48
NDERSHMËRIA QË UDHËZOI BANDITËT	52
ABDULLAH IBN MES'UDI (ra.).....	54
PËRPARIMI I VËRTETË.....	57
ÇLIRIMET SHPIRTËRORE.....	59